



Munih, janar 2025

Informacion për kujdestarët për vlerësimin gjuhësor duke nisur nga marsi 2025

Të nderuar kujdestarë,

Në mars ose prill 2025 do të kryhet për herë të parë një vlerësim i detyrueshëm gjuhësor për të gjithë fëmijët e lindur nga data 01.10.2019 deri më 30.09.2020 dhe që për këtë arsye janë planifikuar të fillojnë shkollën në shtator 2026.

Baza ligjore për këtë në nenin 37, paragrafi 3 i Bayerisches Gesetz über das Erziehungs- und Unterrichtswesen (BayEUG) dhe në nenin 2, paragrafi 1 i Schulordnung für die Grundschulen in Bayern (Grundschulordnung – GrSO) hyri në fuqi më 17.12.2024.

Duke qenë se fëmijës suaj i lind detyrimi për të ndjekur shkollën në vitin 2026/2027, ai duhet të marrë pjesë në vlerësimin gjuhësor, për aq kohë sa nuk ka ndonjë rast përjashtimi.

1. A duhet të marrë pjesë fëmija im në vlerësimin gjuhësor?

Po, pjesëmarrja në vlerësimin gjuhësor është parimisht e detyrueshme.

Përjashtime:

- ✓ Fëmija juaj ndjek një institucion kujdesi ditor të financuar nga shteti dhe keni marrë një deklaratë me shkrim nga institucioni për ta dorëzuar në shkollën fillore të zonës (formular) që fëmija juaj nuk ka nevojë për mbështetje shtesë në lidhje me gjuhën gjermane.
- ✓ Fëmija juaj ndjek një Schulvorbereitende Einrichtung (SVE) dhe keni marrë një deklaratë me shkrim nga atje për ta dorëzuar në shkollën fillore të zonës (formular) që konfirmon pjesëmarrjen.
- ✓ Fëmija juaj ndjek një Heilpädagogische Tageseinrichtung (HPT) dhe keni marrë një deklaratë me shkrim nga atje për ta dorëzuar në shkollën fillore të zonës (formular) që konfirmon pjesëmarrjen.

Në një nga këto raste, ju lutemi dërgojeni deklaratën me shkrim (formularin) menjëherë pas marrjes në versionin origjinal ose në një kopje të noterizuar në shkollën fillore shtetërore nga e cila keni marrë këtë informacion (shkolla fillore, shih pikën 3). Deklarata mund të dërgohet p.sh. me anë të postës, duke e hedhur në kutinë postare të shkollës ose duke e dorëzuar në sekretarinë e shkollës. Nuk mjafton thjesht paraqitja e një kopjeje të deklaratës me shkrim.

- ✓ Sapo shkolla fillore shtetërore përgjegjëse të marrë deklaratën e sipërpërmendur, fëmija juaj nuk do të marrë pjesë në vlerësimin gjuhësor. Në këtë rast nuk duhet të bëni asgjë më tepër.
- ✓ Nuk ka raste të mëtejshme përjashtimi. Nëse fëmija juaj është i sëmurë ose nuk mund ta ndjekë vlerësimin gjuhësor në datën e caktuar, shkolla fillore do të caktojë një datë të re.



2. Pse duhet të marrë pjesë në vlerësimin gjuhësor fëmija im?
 - ✓ Gjuha është çelësi i mëimit të suksesshëm në shkollë dhe i pjesëmarrjes sociale.
 - ✓ Prandaj, fëmijët që kanë nevojë për mbështetje gjuhësore në të ardhmen do të marrin mbështetje të detyrueshme të hershme gjuhësore për t'u mundësuar atyre një fillim të mbarë në jetën shkollore.

3. Kur dhe ku bëhet vlerësimi gjuhësor?
 - ✓ Për vendin, datën dhe orën e vlerësimit gjuhësor ju informon shkolla fillore shtetërore nga e cila keni marrë edhe informacione e paraqitur dhe në rrethin e së cilës ka vendbanimin e zakonshëm fëmija juaj dhe duhet përmbushë në të ardhmen shkollimin e detyrueshëm.
 - ✓ Vlerësimi gjuhësor zhvillohet midis muajit mars dhe prill 2025.
 - ✓ Për këtë do të merrni një ftesë më së voni në shkurt 2025.
 - ✓ Në takim duhet të paraqisni certifikatën familjare ose certifikatën e lindjes së fëmijës (origjinale ose kopje).

4. Kush e kryen vlerësimin gjuhësor dhe çfarë përmban ai?
 - ✓ Vlerësimin gjuhësor me fëmijën tuaj do ta kryejë një mësues i kualifikuar këshillimi (mësues i shkollës fillore) ose një psikolog shkolle. Ju mund të jeni prezent gjatë vlerësimit gjuhësor.
 - ✓ Vlerësimi gjuhësor kryhet duke përdorur Bayerisches Screening des individuellen Sprachstands (BaSiS).
 - ✓ BaSiS është një procedurë që i përshtatet fëmijës dhe moshës së tij, e cila është zhvilluar dhe testuar paraprakisht nga ana shkencore.

5. Sa zgjat vlerësimi gjuhësor me BaSiS?
 - ✓ Vlerësimi gjuhësor zgjat në total rreth 30 minuta (Përshëndetja hyrëse–Kryerja e procesit – Përshëndetja përmbyllëse).
 - ✓ BaSiS përshtatet me aftësinë gjuhësore të fëmijës suaj, në mënyrë që ai të mos jetë i mbingarkuar.

6. Çfarë ndodh pas vlerësimit gjuhësor?
 - ✓ Shkolla fillore do t'ju informojë për rezultatit e vlerësimit gjuhësor brenda një jave nga data e takimit.

7. Ku mund të gjej informacione të mëtejshme?
 - ✓ Informacione të mëtejshme mund të gjeni në <https://www.km.bayern.de/einschulung#sprachstandserhebung>